



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë- Ministarstvo Pravde- Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Kancelarija Ministra - Office of the Minister of Justice

Nr. 38 /2020
Datë: 17/04 /2020

Në mbështetje të nenit 9, (paragrafi 2), nenit 10, (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (GZ nr. 7/01 mars 2019), në pajtim me nenin 50 (paragrafi 1) të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (GZ r. 20/21 qershor 2016), duke u bazuar në nenin 8, (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4) dhe neni 29 (paragrafi 2, nën-paragrafi 2.3) të Rregullores QRK-Nr. 05/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (19.02.2020), Ministria në detyrë e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr. 34/2020, dt: 15/04/2020

1. Ndryshohet pika 1 dhe 4 e vendimit e nr. 34/2020 të datës 5/04/2020 si në vijim:

“1. Z. Dukagjin Neziri, emërohet asistent ekzekutiv i Ministres në detyrë të Drejtësisë”.

“4. Të ardhurat personale të emëruarit nga pika një (1) e këtij vendimi paguhen në vlerën e koeficientit (6.75)”.

2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe fillon të zbatohet nga data 15 prill 2020.

A R S Y E T I M

Në Vendimin e Ministres në Detyrë të Drejtësisë nr. 34/2020 të datës 15/04/2020, me të cilin z. Dukagjin Neziri emërohet zyrtar ligjor në Kabinetin e Ministres në detyrë të Drejtësisë është bërë një lëshim nga Departamenti i Burimeve Njerëzore, ngase një emërim i tillë nuk korrespondon me statusin e kategorisë së të punësuarve në kabinet siç parashihet me nenin 29 të Rregullores QRK-Nr. 05/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (19.02.2020).

Kategoria e të punësuarve sipas nenit 29 të Rregullores së lartcekur janë kategori e veçantë e zyrtarëve publikë, të cilët ofrojnë mbështetje administrative teknike, kurse zyrtarët ligjor janë kategori e nëpunësve civil profesional, statusit, marrëdhënia e punës dhe elementet tjera janë të rregulluar me legjislacionin përkatës në fuqi për shërbimin civil.

Andaj me qëllim të korrigjimit të këtij lëshimi, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Albulena HAXHIU

Ministre në detyrë e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

- *Të emëruarit;*
- *Kabinetit të Ministrit;*
- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*